



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 551/6 Prot.

Tiranë, më 06.10.2025

V E N D I M

Nr. 232, Datë 06.10.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është regjistruar ankesa nr. 73, datë 27.03.2025, e paraqitur nga znj. G.P, kundër Departamentit të Administratës Publike², me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore³”, “bindjes politike⁴”, “vendbanimit⁵” dhe “çdo shkak tjetër⁶”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam arkitekte dhe nëpunëse civile me afro 10 vite përvojë në administratën publike. Ju drejtohem për të denoncuar një rast të trajtimit të pabarabartë dhe manipulimit në procesin e konkurrimit për pozicionin me Kod 6710 – Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, organizuar nga Departamenti i Administratës Publike (DAP).

1. Diskriminim për shkak të gjendjes arsimore.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin DAP ose Departamenti.

³ Mosvlerësimi i arsimit shtesë.

⁴ Mungesa e mbështetjes politike.

⁵ Paragjykim për shkak të origjinës rajonale.

⁶ Pa përcaktuar një cilësi apo karakteristikë personale.

Mosvlerësimi i arsimit shtesë (0/5 pikë).

Kam përfunduar një program pasuniversitar i cili i përket nivelit 7, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK=7), ekuivalente me studimet e nivelit të ciklit të dytë pasuniversitar (Master), përmes të cilit jam licencuar si Vlerësuese e Pasurive të Paluajtshme.

Theksoj se ky program studimi është bërë me kohë të plotë, në institucion arsimor të akredituar dhe lidhet me fushën, objekt i pozicionit të punës ku kam aplikuar. Prandaj duhet të isha vlerësuar me të paktën me 3/5 pikë, ndërsa juria më ka dhënë 0 pikë.

2. Diskriminim për shkak të gjendjes politike, vendbanimit dhe favorizim preferencial. Nënvlërësimi i intervistës me gojë.

Si është e mundur që u jam përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe sërish këto nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kaluar pragun e kualifikimit? Pretendoj që vlerësimi i intervistës sime nga juria nuk pasqyron saktësisht performancën dhe përgatitjen time profesionale 10 vjeçare në institucione që lidhen drejtpërdrejtë me planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Intervistën kam pranuar ta regjistroj zyrtarisht nga DAP, ndaj kërkoj rishqyrtimin e përgjigjeve të mia mbi bazën e regjistrimit (veçanërisht Pyetjes 2 (6/10 pikë) dhe Pyetjes 3 (7/10 pikë). Theksoj se u jam përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe kjo absolutisht që duhet të ishte e mjaftueshme për të kaluar pragun e kualifikimit!

- Diskriminim për shkak të mungesës së mbështetjes politike.

Si pjesë e një familjeje ushtarakësh të depolitizuar, dyshoj se mungesa e lidhjeve politike ka ndikuar negativisht në vlerësimin tim profesional. Në një mjedis ku lidhjet politike shpesh luajnë rol thelbësor në avancimin në karrierë, besoj se mungesa e një mbështetjeje të tillë ka ndikuar edhe në pengimin e ngritjes sime në detyrë.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për 8-9 vite dhe përmbushjes së plotë të kriterëve të vendosura, gjatë intervistës me gojë kam qenë subjekt i një vlerësimi nën nivelin e kërkuar për kualifikim. Megjithatë kam dhënë përgjigje të sakta për të gjitha pyetjet (siç mund të vërtetohet edhe nga regjistrimi i intervistës), jam nënvlerësuar nga juria, duke mos arritur të kaloj pragun e nevojshëm të kualifikimit. Ky fakt ngre dyshime të arsyeshme mbi paanshmërinë e procesit vlerësues.

- Diskriminim me qëllim paragjykimin për shkak të origjinës rajonale.

Gjatë intervistave kam vërejtur shenja të qarta paragjykimin në lidhje me origjinën time nga Veriu, (shpeshherë të kamufluara përmes shprehjeve me tone shakaje).

Në intervistën për pozicionin me Kod 6710, anëtarja e jurisë shfaqti habi kur dëgjoi se punoja në Kukës dhe bëri një koment përkatës për këtë (mendoj që ajo s'kishte pse të shprehte habi për këtë, pasi mendohet që është njohur me cv-në e kandidatit përpara, dhe shfaqja e habisë në atë moment kur mori vesh që punoja në Kukës më la të kuptoj për këtë diskriminim). Ndërhyrja e menjëhershme e përfaqësueses së DAP-it, e cila u përpoq ta devijonte bisedën duke pohuar në

emrin tim me një argument të thjeshtë se isha aty për ngritje në detyrë më bëri të mendoj që komenti i anëtares së jurisë ishte tendencioz dhe automatikisht u ndjeva objekt paragjykimi dhe diskriminimi për shkak të origjinës rajonale (për të provuar këtë pretendim ju ftoj të dëgjoni me vëmendje intervistën). Theksoj se ky lloj qëndrimi krijon perceptimin së kandidatët nga veriu ndeshen me pengesa (paragjykime) për t'u emëruar në pozita “drejtuesi të vogël apo të mesëm” në Tiranë, duke përbërë një formë diskriminimi të pajustificuar.

- *Diskriminim me qëllim favorizimi i kandidatës sipas preferencave të jurisë.*

Kam arsye të besoj se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar mbi bazën e meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme. Megjithatë kam tejkaluar kriteret e vendosura, vlerësimi i intervistës nga juria rezultoi nën pragun e kualifikimit. Ky rezultat, i papërrputhshëm me përgatitjen dhe performancën time të dëshmuar gjatë procesit, ngre dyshime mbi objektivitetin e jurisë. Kjo situatë sugjeron që vlerësimi mund të jetë orientuar për të favorizuar një kandidat tjetër, në përputhje me preferenca të caktuara, gjë që bie ndesh me parimet e barazisë dhe drejtësisë në përzgjedhjen për pozicione drejtuese”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (në vijim LMD), parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 551/1, datë 03.04.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga DAP, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion dhe argumente lidhur me pretendimet e ngritura nga ana e znj. G.P.
 - Kopje të plotë të dosjes së dokumenteve të dorëzuara nga ankuesja.
 - Kopje të procedurës së konkurrimit për shpalljen e vendit të punës nr. 6710, Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 - Procesverbalet e mbajtura të konkurrimit/vlerësimit të kandidatëve gjatë testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, për shpalljen e vendit të punës nr. 6710 dhe kopje të regjistrimit të intervistës të ankueses.
 - Kopje të korrespondencës së mbajtur mes ankueses dhe DAP lidhur me procedurën e ndjekur për trajtimin e ankesës së saj, sa i përket procedurave të konkurrimit për shpalljen nr. 6710.
 - Kush është kandidati fitues/emëruar në pozicionin e punës sipas shpalljes nr. 6710, dhe kopje të dosjes dhe vlerësimit nga Komisioni?
 - Informacion dhe kopje të korrespondencës, nëse ka patur ankesa të tjera nga kandidatët/konkurrentët e tjerë në këtë procedurë konkurrimi.

Me shkresën me nr. 400/3, datë 14.04.2025, DAP dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi se: *“Nga të dhënat e administruara nga DAP rezulton se znj. G.P ka marrë pjesë në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – klasa e pagës III-I.*

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe kreut III të VKM nr. 242, datë 18.03.2013 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulet dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, procedura e ngritjes në detyrë përfshin dy faza:

- Verifikimin paraprak, i cili kryhet nga njësia përgjegjëse (DAP), në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, për plotësimin e kushteve dhe kërkesave të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- Vlerësimi i kandidatëve, i cili kryhet nga Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë, vlerësimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë.

Znj. G.P ka plotësuar kushtet për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe ka zhvilluar testimin me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë, për këtë procedurë konkurrimi me datë 10.01.2025.

Pas njoftimit të vlerësimit të rezultatit individualisht me email, znj. G.P ka paraqitur ankesë me shkrim për vlerësimin, e cila është trajtuar nga anëtarët e KPND-së, të cilët kanë dhënë përgjigje me procesverbalin e datës 24.01.2025, të përcjellë me shkresën e DAP-it me nr. 400/1, datë 27.01.2025.

Përsa i përket pretendimeve të ngritura nga kandidatja, po ju paraqesim argumentet si vijon:

- Mbi pretendimin për mosvlerësim të arsimit shtesë:

Vlerësimi i elementeve të jetëshkrimit (jetëshkrimi, arsimi, përvoja, trajnimet e lidhura me fushën dhe vlerësimi i fundit i punës) realizohet bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të DAP “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimin të hapur”, duke mbajtur në konsideratë kërkesat e posaçme që përcaktohen në shpalljen për konkurrim dhe dokumentacionin në dosjen elektronike të kandidatit.

Referuar procesverbalit të datës 24.01.2025, rezulton se kandidatja është sqaruar për vlerësimin e jetëshkrimit si vijon:

- Në lidhje me jetëshkrimin është vlerësuar me pikët maksimale, 5 pikë.*
- Në lidhje me arsimin e lidhur me pozicionin është vlerësuar me 0 pikë nga 5 pikë maksimalja, pasi plotëson kriterin e arsimit me diplomën “Master Shkencor” në “Arkitekturë”, dhe nuk zotëron diplomë/a shtesë.*
- Në lidhje me përvojën e lidhur me pozicionin është vlerësuar me pikët maksimale, 5 pikë.*
- Në lidhje me trajnimin e lidhur me fushën është vlerësuar me 3 pikë nga 3 pikë maksimalja.*
- Në lidhje me vlerësimin e fundit në punë është vlerësuar me 2 pikë për vlerësimin në nivelin “shumë mirë”.*

Sipas Udhëzimit nr. 2 të sipërcituar, kandidati vlerësohet me 1 pikë kur ka arsim shtesë të pambaruar dhe me 3 pikë kur ka arsim shtesë të mbaruar. Vlerësimi maksimal prej 5 pikësh, për tejkalim domethënës të kërkesave, merret vetëm në rastin kur kandidati zotëron gradë arsimore shtesë.

Pretendimi i ngritur nga znj. G.P për vlerësim të arsimit me 3 pikë nuk qëndron, pasi nuk zotëron diploma të nivelit Bachelor apo Master mbi kriterin e përcaktuar në shpallje, në mënyrë që të ishin pjesë e vlerësimit. Kursi i formimit të vazhduar “Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme”, në përfundim të së cilit znj. G.P është pajisur me certifikatë, është licencim profesional bazuar në VKM-në nr. 712, datë 12.10.2016, “Për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”. Kjo certifikatë nuk është e barazvlefshme me studimet Master, referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programet e ciklit të dytë të studimeve organizohen

me 60, 90 apo 120 kredite, dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” apo “Master Profesional”, në fushën e arsimimit të kryer.

- Mbi pretendimin për nënvlerësim të intervistës me gojë:

KPND ka ridëgjuar dhe rivlerësuar intervistën e strukturuar me gojë dhe ka zbatuar me përpikmëri të plotë parashikimet e Kreut V/6, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP.

Vlerësimi i bërë nga anëtarët e KPND-së është një akt diskrecionar i këtij të fundit dhe diskrecioni materializohet në përzgjedhjen e pyetjeve konkrete që bëhen gjatë intervistës së strukturuar me gojë. KPND-ja, ditën e intervistës së strukturuar me gojë, zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët pjesëmarrës. Pjesë e diskrecionit të KPND-së është edhe përcaktimi i përgjigjes së saktë për çdo pyetje të shtruar kandidatit, po ashtu edhe vlerësimi i bërë në pikë konkrete për secilën përgjigje të dhënë nga kandidati. Pra, intervista është diskrecion i organit publik administrativ të ngarkuar me ligj dhe nuk mund të ngrihen ankesa me karakter material, por vetëm me natyrë procedurale. Në këto kushte, meqenëse kemi të bëjmë me një diskrecion të KPND-së që ushtrohet dhe lind prej parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, si dhe VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, të ndryshuar, përcaktimi i pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë dhe përgjigjeve të tyre është në kompetencën ekskluzive të këtij organi, në përbërje të së cilit ka ekspertë të fushës dhe nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues. Për sa kohë, KPND garanton parimin e transparencës dhe shanseve të barabarta ndërmjet kandidatëve, procesi përzgjedhës është i rregullt dhe ligjor.

- Mbi pretendimin për diskriminim për shkak të origjinës, mungesës së mbështetjes politike, etj:

Bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të DAP, KPND nuk bën pyetje në lidhje me moshën, gjendjen civile, gjendjen familjare ose planet, preferencat fetare, pikëpamjet politike, etj. Anëtarët e KPND-së kanë vlerësuar kandidatët në këtë procedurë konkurrimi, përfshirë znj. G.P, bazuar në meritë dhe aftësi profesionale. Kështu, vendimi për përzgjedhjen e kandidatit fitues në këtë konkurs është bazuar në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, të treguara në testimin me shkrim, intervistën me gojë dhe jetëshkrimin. KPND ka trajtuar në mënyrë të barabartë kandidatët, pa dallim bindjesh politike, fetare, përkatësie etnike, origjine, etj, duke garantuar një proces përzgjedhës transparent dhe të drejtë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pavarësisht pretendimeve të ngritura nga znj. G.P, pyetjet e intervistës me gojë, janë bazuar vetëm në fushën e njohurive të përcaktuara në shpallje, siç konstatohet nga lista e pyetjeve bashkëlidhur kësaj shkrese. Pyetjet janë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe procedura e vlerësimit që është ndjekur nga anëtarët e KPND-së është bazuar në parashikimet e udhëzimit të sipërcituar. Kjo vërtetohet nga formularët për vlerësimin individual të kandidatëve, si dhe raporti dhe vendimi për rezultatin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Po ashtu, pretendimi për diskriminim për arsye të pikëpamjeve politike nuk është i bazuar, pasi sikurse është sqaruar edhe më lart, kualifikimi i kandidatëve është bazuar në përmbushjen e kushteve për ngritjen në detyrë dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim,

referuar nenit 25 të ligjit nr. 152/2013, dhe nenit 2, të kreut III, të VKM-së nr. 242, 18.03.2015, të ndryshuar.

Në përfundim të fazës së ankimit, bazuar në nenin 36, Kreu III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, të ndryshuar, njësia përgjegjëse shpalli znj. E.D fituese për pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - klasa e pagës III-I, dhe publikoi njoftimin në faqen zyrtare të DAP”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 16.04.2025, është njohur me përgjigjen e DAP-it.

Me email-in, datë 21.04.2025, subjekti ankues ka dërguar kundërshtimet e saj, duke informuar si më poshtë: “Kundërshtimet përfshijnë në mënyrë të përmbledhur këto çështje kryesore:

1. Diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore.

Bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, pika V/6.1, kundërshtoj interpretimin e DAP për pikëzimin e arsimit. Kam mbaruar një Program arsimor shtesë (vlerësuar KSHK=7), për të cilin kërkoj vlerësimin prej 3 pikësh. Nuk kam pretenduar pikë për një gradë të re arsimore (5 pikë), por për përfundimin e një arsimit të mbaruar (3 pikë), siç parashikohet në udhëzim. Interpretimi i KPND është i pasaktë dhe nuk reflekton përmbajtjen e kërkesës sime.

2. Mungesë transparence dhe përdorim i papërshtatshëm i diskrecionit nga KPND në vlerësimin e intervistës.

Komisioni ka shfaqur mungesë të analizës cilësore dhe objektive të intervistës me gojë, ndërsa është mbështetur tërësisht në “diskrecionin” e tij për të shmangur llogaridhënien. Në kushtet kur ekziston prova e regjistrimit audio të intervistës – të cilën unë e kam pranuar për qëllime transparence – aktet diskrecionare nuk mund të konsiderohen më të pakontestueshme dhe duhen kontrolluar për mënyrën e ushtrimit të tyre (kontrollim për të verifikuar nëse janë ushtruar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo selektive). Mungesa e çdo analize të vlerësimit të intervistës ngre dyshime legjitime mbi objektivitetin dhe barazinë në proces.

3. Shkelje e udhëzimeve gjatë intervistës.

Gjatë intervistës, një anëtar i komisionit ka formuluar një pyetje të papërshtatshme që lidhet me planet: “Pse dëshiron të vish këtu?”, e cila – siç dëshmohet nga regjistrimi audio – është në shkelje me pikën 14, të Udhëzimit nr. 2, datë 27.03.2015, që ndalon pyetjet e kësaj natyre që lidhen me planet.

4. Diskriminim me qëllim favorizimi i kandidatës sipas preferencave të komisionit vlerësues.

Dyshime të arsyeshme mbi favorizim të kandidatës fituese në kundërshtim me parimet e meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme. Kam kërkuar që për transparencë të bëhet një analizë

krahasuese mes meje dhe kandidates fituese (E.D), përfshirë Cv, Edukimin/Arsimin, përvojën/eksperiencën dhe performancën në intervistë. KPND nuk ka ofruar asnjë informacion apo provë që të argumentojë vlerësimin më të lartë të saj, krahasuar me mua.

Unë kam pranuar regjistrimin e intervistës nga DAP, në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, për të garantuar një proces të drejtë, të dokumentuar dhe të kontrollueshëm. Kjo ka qenë një zgjedhje e vetëdijshme për të siguruar që vlerësimi i performancës sime të jetë objektiv dhe i verifikueshëm.

Megjithatë, nuk kam informacion nëse kandidatja e shpallur “fituese” ka pranuar gjithashtu regjistrimin e intervistës së saj. Nëse një gjë e tillë nuk ka ndodhur, atëherë Komisioni (KPND) nuk ka në dispozicion prova të drejtpërdrejta e të krahasueshme mbi cilësinë e përgjigjeve të saj në raport me të miat. KPND nuk mund të provojë dot që përgjigjet e saj kanë qenë më të mira/më të argumentuara se të miat. Si rrjedhojë, vendimi i KPND bie në arbitraritet dhe mungesë provash krahasuese. Kjo sjell dy pasoja të rëndësishme:

- *Mungesa e balancës në vlerësim: Njëra palë (unë) është e dokumentuar në detaje, ndërsa pala tjetër jo. Kjo krijon një hendek në mënyrën se si janë vlerësuar kandidatët.*
- *Vendim arbitrar dhe i pambështetur në prova të krahasueshme: Në mungesë të regjistrimit apo të një forme tjetër të dokumentimit të intervistës së kandidates fituese, KPND nuk mund të provojë objektivisht se përgjigjet e saj kanë qenë më të mira se të miat.*

Prandaj kam arsye të besoj se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar mbi bazën e meritokracisë dhe konkurrencës së ndershme”.

- *Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 551/3, datë 17.06.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 26.06.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.*

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 26.06.2025, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, znj. G.P dhe përfaqësuesve me autorizim nr. 3292/1, datë 23.06.2025, të Departamentit të Administratës Publike, z. A.N dhe znj. F.V.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit me email dhe shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës dëgjimore, DAP me email-in datë 04.07.2025, në mes të tjerash ka informuar si vijon: “Referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar

niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Këto programe organizohen me jo më pak se 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor”. Programet e studimeve Master organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master profesional” ose “Master Shkencor”.

Certifikata “Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme” që zotëron znj. G.P ka 28 kredite dhe kohëzgjatje 20 javë. Në kuptim të ligjit nr. 80/2015, nuk është e barazvlefshme me programet e studimeve “Bachelor” apo “Master”.

Ky qëndrim është mbajtur në të gjitha rastet kur kandidatët zotërojnë licenca të ushtrimit të profesionit, njësoj si edhe për certifikatën Avokat, e cila merret në përfundim të shkollës së Avokatisë, duke i konsideruar këto certifikime si trajnime të lidhura me fushën dhe jo arsim shtesë.

Edhe në rastin në fjalë, certifikata “Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme” që zotëron znj. G.P është konsideruar trajnim i lidhur me fushën dhe kandidatja ka marrë vlerësimin maksimal për trajnimet 3 pikë nga 3 pikë të mundshme.

Lidhur me diskriminim për shkak të origjinës.

Nisur nga fakti se në seancën dëgjimore ankuesja ngriti pretendim se kandidatët të cilët janë me origjinë nga veriu i Shqipërisë, nuk emërohën në pozicione drejtuese në administratë, sjellim në vëmendjen tuaj disa raste të emërimit të kandidatëve në pozicione të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, pavarësisht vendit të origjinës.

Nr.	Pozicioni	Kandidati fitues	Vendlindja
1	#6685-Përgjegjës i Sektorit të Shëndetit, Mbrojtjes së Bimëve dhe Mbetjet, në Drejtorinë e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehrave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - klasa e pagës III-1	I.B	Dibër
2	#6897-Përgjegjës i Sektorit për Përgatitjen e Dokumenteve të Prokurimit, në Drejtorinë për Menaxhimin e Kontratave IPA, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë - klasa e pagës III-1	K.K	Kukës

3	#6951-Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Sigurisë, në Drejtorinë e Auditimit, në Ministrinë e Brendshme klasa e pagës III-1	M.M	Shkodër
4	#6004-Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë - Kategoria: II-b	F.D	Lezhë
5	#6087-Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit, në Drejtorinë e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, në Ministrinë e Brendshme - Kategoria: III-a	A.V	Shkodër

Sa më sipër, ju bëjmë me dije se njoftimet e fituesve i gjeni të publikuara edhe në faqen zyrtare <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/b, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen arsimore, bindjen politike dhe vendbanimin, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Referuar shkresës nr. 554, datë 29.05.2015, të Komisionit të Njohjes së Diplomave (MAS), vërtetohet se znj. G.P, i është njohur diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, me program 4-vjeçar, 240 ECTS, në Arkitekturë, e njësuar si Bachelor në Republikën e Shqipërisë.

Referuar shkresës nr. 2297/2, datë 09.08.2019, të Komisionit të Njohjes së Diplomave (QSHA), vërtetohet se znj. G.P, i është njohur diploma e lëshuar nga Universiteti i Tetovës, me kohëzgjatje 1-vjeçare, 60 ECTS, në Arkitekturë, e njësuar si Master i Shkencave në Republikën e Shqipërisë.

Referuar Certifikatës nr. 223, nr. i regjistrimit 247, datë 10.06.2024, të lëshuar nga Universiteti “Metropolitan Tirana”, vërtetohet se Znj. G.P ka përfunduar me sukses Kursin e Formimit të Vazhduar *“Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme”*, me kohëzgjatje 20 javë, kredite 28 ECTS, KSHK 7-të.

Në muajin dhjetor 2024, ankuesja është vënë në dijeni të shpalljes publike nga DAP, të pozicionit me Kod 6710, Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – klasa e pagës III-I. E interesuar për këtë pozicion, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj për këtë pozicion në portalin e DAP-it, brenda datës 14.12.2024, të përcaktuar në shpalljen e pozicionit të sipërcituar për aplikimin dhe dorëzimin e dokumenteve online për procedurën e ngritjes në detyrë.

Neni 26, i Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, *“Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese”*, parashikon se:

1. *Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.*
2. *Këto procedura organizohen nga njësia përgjegjëse, për një ose disa pozicione të lira të ngjashme, bazuar në parimin e përmendur në nenin 20 të këtij ligji.*
3. *Mund të aplikojnë për procedurat, sipas pikës 1 të këtij neni:*
 - a. *nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira nëpërmjet lëvizjes paralele;*

- b. nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.
4. Përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.
5. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:
- a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira;
 - b) vlerësimi i kandidatëve.
6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga komiteti i pranimit, që ngrihet nga njësia përgjegjëse.
7. Në përfundim të vlerësimit, komiteti mund të vendosë:
- a) përzgjedhjen e kandidatit që është renditur i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve; apo
 - b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.
8. Nëse vendi i lirë nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nëse është e nevojshme, mund të zbatohet procedura e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 48 të këtij ligji.
9. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurën e hollësishme për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese.

Në Kreun III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, parashikon:

"... 7. Vlerësimi i kandidatëve për ngritjen në detyrë realizohet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), i cili ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin;

b) Për institucionet e administratës shtetërore, 1 (një) anëtar nga institucioni që ka vendin vakant, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, i përcaktuar nga DAP-i. Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, 1 (një) anëtar i zgjedhur nga titullari midis nëpunësve civilë të institucionit, nëse është e mundur të nivelit të mesëm drejtues;

c) Eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi;

ç) 2 (dy) ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit.

8. 9.

10. Ekspertët zgjidhen nga njësia përgjegjëse, për secilën KPND, duke patur në konsideratë karakteristikat e pozicionit, për të cilin do të zhvillohet procedura e konkurrimit.

11. Ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion.

12. 13.....

14. KPND-ja merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

15. Për çështje procedure, vendimet merren me votim nominal.

16. Për vlerësimin e rezultateve për secilin kandidat, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara për secilën fazë mbledhen. Rezultati përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.

17. Përpara zhvillimit të vlerësimit me shkrim, testet e kandidatëve pjesëmarrës sekretohen, sipas mënyrës së përcaktuar nga njësia përgjegjëse.

18. 19. 20.

21. Konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë përfshin dy faza:

- a) verifikimin paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimin e kandidatëve.

22. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimi të tyre, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

23. Në përfundim të verifikimit, sipas pikës 22 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

24..... 25.

26. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 25 të kreut III të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikur kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

27. Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, përvojës e trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve individuale në punë;
- b) b) vlerësimi me shkrim;

c) intervista e strukturuar me gojë.

28. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar;
- b) 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c) 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

29. KPND-ja, 24 (njëzetëkatër) orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimit të kandidatëve, zgjedh një grup pyetjesh për testimin e fushës së njohurive, të aftësive e të cilësive të shpallura në shpalljen për konkurrim.

30. KPND-ja, ditën e intervistës së strukturuar me gojë, zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët. Intervista e strukturuar me gojë ka për qëllim vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive, aftësive dhe formimit të kandidatëve.

31. Kandidati/kandidatët fitues është/janë ai/ata që renditet/en i pari/të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 24 të Kreut II të këtij vendimi.

32..... 33..... 34.....

35. Kandidati, pavarësisht nga e drejta për t'u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në KPND për rezultatin e pikëve, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

36. Njësia përgjegjëse, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike, pas përfundimit të procedurave të ankimit, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit të kandidatit”.

Sa më sipër, njësia përgjegjëse e DAP, ka kryer procedurën e verifikimit paraprak të dosjeve të aplikantëve, nëse ata i plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrit. Referuar provave të administruara, rezulton se në fazën e parë, atë të verifikimit paraprak të dosjeve, janë kualifikuar për të vijuar fazën e dytë të konkurrit 5 (pesë) kandidatë.

Më pas, ankuesja dhe kandidatët e kualifikuar, janë njoftuar nga DAP për zhvillimin e testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë më datë 10.01.2025.

DAP me Urdhrin nr. 25, datë 09.01.2025, “Për krijimin e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë”, ka ngritur KPND, me përbërjen si më poshtë:

1. Znj. F.V – Specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, në Departamentin e Administratës Publike – Kryetar;
2. Znj. Z.G – Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – eprori direkt;

3. Znj. L.R – Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – përfaqësues nga institucioni i zgjedhur nga DAP;
4. Znj. K.T (ekspert) – anëtar;
5. Z. A.B (ekspert) – anëtar.

Referuar procesverbalit datë 10.01.2025, të mbajtur nga KPND, rezulton se në testimin me shkrim dhe në intervistën e strukturuar me gojë kanë marrë pjesë 4 kandidatë, (E.D, E.H, Znj. G.P dhe M.K), ndërsa kandidatja R.M, nuk është paraqitur.

Referuar Deklaratave mbi regjistrimin me zë të intervistës me gojë, rezulton se kandidatët: E.D dhe E.H nuk kanë dëshiruar regjistrimin e intervistës me gojë, ndërsa kandidatët: G.P dhe M.K kanë pranuar regjistrimin e intervistës me gojë.

Referuar Formularit për vlerësimin individual të kandidates G.P të plotësuar nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, rezulton vlerësimi i ankueses në tabelën si më poshtë:

1. Vlerësimi i dokumentacionit:

Kriteret	Anëtar I	Anëtar II	Anëtar III	Anëtar IV	Anëtar V	Shuma:
Jetëshkrimi, 5 pikë për jetëshkrimin	5	5	5	5	5	
Arsimi, deri 5 pikë për arsimin e lidhur me fushën	0	0	0	0	0	
Përvoja në punë, deri në 5 pikë për përvojën e lidhur me fushën	5	5	5	5	5	
Trajnimi, deri në 3 pikë për trajnimin e lidhur me fushën	3	3	3	3	3	
Vlerësimi, deri në 2 pikë për vlerësimin më të fundit pozitiv	2	2	2	2	2	

Total 15 pikë

2. Vlerësimi i intervistës:

Pyetja	Anëtar I	Anëtar II	Anëtar III	Anëtar IV	Anëtar V	Shuma:
Pyetja 1	5	5	5	5	5	
Pyetja 2	6	6	6	6	6	
Pyetja 3	7	7	7	7	7	
Pyetja 4	5	5	5	5	5	

Total 23 pikë

3. Vlerësimi i testimit me shkrim:

Gjithsej 26 pikë nga 40 maksimalja.

Në përfundim të vlerësimit, KPND ka mbajtur Raportin datë 16.01.2025 *“Për rezultatin e procedurës së ngritjes në detyrë”*, me renditjen e kandidatëve si më poshtë:

Emri/mbiemri i kandidatit	Pikët për dokumentet e dorëzuara	Pikë për intervistën me gojë	Pikë për testimin me shkrim	Shuma totale e pikëve
E.D	12 / 20	36.2 / 40	38 / 40	86.2 pikë
M.K	12 / 20	28.6 / 40	26 / 40	66.6 pikë
G.P	15 / 20	23 / 40	26 / 40	64 pikë
E.H	12 / 20	1 / 40	30 / 40	43 pikë

Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë me Vendimin datë 27.01.2025, ka vendosur: *“Përzgjedhjen e znj. E.D, si kandidate e cila renditet me të paktën 70 pikë, për tu emëruar në pozicionin me kod #6710 - Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – klasa e pagës III-I”*.

Ankuesja pasi është njohur me rezultatin e vlerësimit, bazuar në Kreun III, pika 26 të VKM nr. 242, datë 18.03.2015, është ankuar me shkrim pranë DAP-it duke kërkuar rishikimin e vlerësimit të saj në të tre komponentët.

Në përgjigje të kësaj ankese, KPND, është mbledhur në datën 24.01.2025 për të shqyrtuar ankesën e znj. G.P. Në përfundim të shqyrtimit, KPND ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës përcjellëse të DAP me nr. 400/1, datë 27.01.2025. Në procesverbalin e mbajtur nga KPND në datë 24.01.2025, rezulton se Komiteti ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e ankueses lidhur me jetëshkrimin, intervistën me gojë dhe testimin me shkrim dhe në përfundim ka vendosur mosndryshimin e vlerësimit të ankueses.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se KPND ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe gjatë shqyrtimit të ankimit dhe të kandidates të renditur në vend të dytë znj. M.K, e cila është ankuar për jetëshkrimin dhe intervistën me gojë. Dhe në këtë procedurë KPND ka vendosur mosndryshimin e vlerësimit të znj. M.K.

Në Udhëzimin nr. 02, datë 27.03.2015 *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes së detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*, parashikohet se: *“Kreu V/3 Detyrat e Komitetit të Pranimi për Ngritjen në Detyrë, pika 2.*

KPND është organ kolegjal. Çdo anëtar i KPND vlerëson dokumentet e kandidatëve, si dhe bën vlerësimin e kandidatëve gjatë vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë në mënyrë individuale, duke dhënë pikët përkatëse. Rekomandohet që anëtarët e KPND të diskutojnë në lidhje me pikët përpara se të japin rezultatin përfundimtar”.

Në Kreun V/6 të këtij udhëzimi parashikohet vlerësimi i jetëshkrimit, përgatitja për intervistën e strukturuar me gojë, dhe vlerësimi i intervistës së strukturuar me gojë, si më poshtë:

“1. Pikët totale për vlerësimin e jetëshkrimit janë 20 dhe ndahen si vijon:

a) Jetëshkrimi 5 pikë për secilin nga kandidatët e seleksionuar për vlerësim.

b) deri në 5 pikë për vlerësimin e arsimit të lidhur me pozicionin:

- 1 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave – arsimim shtesë (pa mbaruar);
- 3 pikë për tejkallim të kërkesave – arsimim shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë;
- 5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - gradë arsimore shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë në fushën që është veçanërisht e rëndësishme për institucionin.

c) deri në 5 pikë për përvojën e lidhur me fushën:

- *1 pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit përvojë shtesë në fushën e kërkuar ose përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;*
- *3 pikë për tejkallim të kërkesave - nga 1-3 vite përvojë shtesë në fushën e kërkuar, ose përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;*
- *5 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 3 vjet përvojë shtesë në fushën e kërkuar, ose përvojë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.*

ç) deri në 3 pikë për trajnimin e lidhur me fushën:

- *1 pikë për tejkallim të kërkesave – 1 - 2 trajnime shtesë;*
- *3 pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 2 trajnime shtesë.*

ç) deri në 2 pikë për dy vlerësimet më të fundit pozitive:

- *1 pikë për vlerësimin në nivelin “mirë”;*
- *2 pikë për vlerësimin në nivelin “shumë mirë””.*

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se ankuesja është e pajisur me Certifikatë për përfundimin e Kursit të Formimit të Vazhduar “Vlerësimi dhe Investimi i Pasurive të Paluajtshme”, me kohëzgjatje 20 javë, kredite 28 ECTS, KSHK 7-të, certifikatë e cila nga ana e KPND nuk është vlerësuar si gradë arsimore shtesë ose diplomë shtesë, pasi nuk është e barazvlefshme me programet e studimeve “Bachelor” apo “Master”. Referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë, referuar niveleve 6-8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në nenin 73 të ligjit

përcaktohet se: *“Programet e ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike”,* ndërsa në nenin 75 parashikohet se: *“3. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike; b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike.....”.*

Mbështetur edhe në interpretimin e DAP, por edhe në përcaktimet e cituara në ligjin 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”*, rezulton se certifikata e fituar nga ankuesja me 28 ECTS, nuk plotëson kriteret për tu përfshirë në rubrikën e arsimit, si arsim shtesë ose diplomë shtesë, por nga KPND është vlerësuar tek rubrika e trajnimeve, për të cilën është vlerësuar me pikët maksimale.

Lidhur me vlerësimin e certifikatës së ankuseses, DAP ka informuar se ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe për kandidatët e tjerë të cilët zotëronin licenca të ushtrimit të profesionit dhe certifikatën për avokat, kur ka vlerësuar këto certifikata si trajnime të lidhura me fushën dhe jo arsim shtesë.

- *Lidhur me pretendimin e ankuseses për paragjykimin e saj për shkak të origjinës nga veriu dhe pyetjeve të KPND, gjatë intervistës me gojë.*

Ankuesja ka pretenduar se një anëtar i komitetit ka bërë një koment kur ka dëgjuar se ankuesja punonte në Kukës dhe një anëtar i komitetit e ka pyetur *“Pse dëshiron të vish këtu?”*.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se KPND ka pasur të pregatitur dokumentin me listën e pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë, për të gjithë kandidatët që janë bërë pjesë e procedurës së intervistës me gojë, dokument i cili është firmosur nga të gjithë anëtarët e KPND dhe ishte i përbërë nga katër pyetje, të vlerësuara me nga 10 pikë.

Referuar regjistrimit audio të intervistës me gojë të ankuseses, rezulton se nga ana e anëtarëve të KPND-së, nuk është bërë asnjë koment apo pyetje në lidhje me moshën, gjendjen civile, gjendjen familjare ose planet, preferencat fetare apo pikëpamjet politike, pyetje të cilat janë të ndaluara të bëhen nga KPND, referuar Kreut II/2, pikës 14, të Udhëzimit nr. 2/2015.

Gjithashtu, DAP me email-in datë 22.01.2025, ka njoftuar ankuesen për tu paraqitur në datë 23.01.2025, në mjediset e DAP-it për tu njohur me testimin me shkrim dhe çelësin e përgjigjes, por ankuesja nuk është paraqitur.

Lidhur me pretendimet e ankuseses për saktësinë e vlerësimit të pyetjeve me gojë dhe me shkrim, DAP ka informuar Komisionerin se: *“Përcaktimi i pyetjeve të intervistës së strukturuar me gojë dhe përgjigjeve të tyre është në kompetencën ekskluzive të KPND, në përbërje të së cilit ka ekspertë të fushës dhe nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues”.*

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, rezulton se të gjithë kandidatët që janë bërë pjesë e procedurës së intervistës me gojë, i janë nënshtruar të njëjtave pyetje me ankuesen. Referuar analizës së bërë akteve ligjore të sipërcituara, sa i përket procedurës së intervistës me gojë, rezulton që KPND është organi i cili përzgjedh fondin e pyetjeve për aplikantët që i nënshtrohen kësaj procedure.

Lidhur me arsyetimin e mësipërm të dhënë nga DAP, Komisioneri vlerëson se për shkak të natyrës teknike dhe profesionale, nuk zotëron ekspertizën e nevojshme për të vlerësuar përmbajtjen e pyetjeve dhe çelësin e përgjigjeve të vendosura nga KPND-ja, por vlerëson se bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e KPND, të cituara më sipër, KPND-ja ka kompetencën dhe ekspertizën e duhur për të bërë përzgjedhjen e pyetjeve, përgjigjen e saktë të pyetjeve dhe për të vlerësuar përgjigjet me gojë dhe me shkrim të kandidatëve.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e DAP-it, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat, në mbështetje të akteve ligjore/nënligjore, për procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin: Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë – klasa e pagës III-I.
- Ankuesja nuk është vendosur në kushte të pabarabarta nga ana e DAP-it, pasi ky institucion ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me trajtimin e ankesave të bëra nga kandidatët dhe për vlerësimin e kualifikimeve të ndryshme të kandidatëve.
- KPND-ja ka kompetencën dhe ekspertizën e parashikuar në aktet ligjore, për përzgjedhjen e pyetjeve, çelësin e përgjigjeve dhe vlerësimin e përgjigjeve të kandidatëve, sipas fushës së ekspertizës së tyre.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Në nenin 12/1/b) të Ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohe diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet

viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se Departamenti i Administratës Publike, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues dhe për rrjedhojë nuk provohet se Departamenti i Administratës Publike ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të ankuseses Znj. G.P, nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për shkaqet e pretenduara prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA